



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CML.nr.10/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Erdogan Haxhibeqiri, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Muhamet Rexha, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve: NP “K.I.”; “B. I.”; “A. K.”; “A.”; “M. T.”; “B.; “A. I.”; “Gj. O.”; dhe “A. I.”, që të gjithë me seli në P., të cilët i përfaqëson avokat Shemsi Uka nga P., kundër debitorit N. Sh., S., K. dhe E. - NSH P. i R., Kulturës dhe Sporteve, me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Korab Rexhepi, avokat në P., lidhur me çështjen përmbartimore, për kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me kërkesën e debitorit për mbrojtje të ligjshmërisë, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1961/2019 të datës 09.03.2020 dhe aktvendimit të Gjykatës Apelit të Kosovës Ac.nr.3599/2020, datë 15.09.2021, në seancën e mbajtur më datë 08.02.2022, mori këtë

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1961/2019 të datës 09.03.2020 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.3599/2020, të datës 15.09.2021.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1961/2019 të datës 09.03.2020, refuzohet e pabazuar kërkesa për eliminimin e parregullsive në veprimet përmbartimore si dhe anulimi i konkluzionit P.nr.162/2015, për

ndryshimin e llogaritjes së kamatës, i marrë nga Zyra Përmbare e Përmbaresit Privat Arben Gashi, në territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Në procedurën e ankesës së paraqitur nga debitori, Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.3599/2020, të datës 15.09.2021, e ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e debitorit N. Sh., S., K. dhe E. - NSH Pallati i Rinisë, Kulturës dhe Sporteve, me seli në P., ndërsa aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, e ka vërtetuar.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Prokurori i Shtetit me kohë ka paraqitë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 247 paragrafi 1, pika a) të Ligjit për procedurën Kontestimore (LPK).

Në kuptim të dispozitës së nenit 250 të LPK-së, gjykata ka caktuar seancën dëgjimore për të cilën janë njoftuar Prokurori i Shtetit dhe palët ndërgjyqësore, ndërsa prezent ishin vetëm përfaqësuesit e palëve, kreditorit dhe debitorit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 251 të LPK-së, shqyrtoi kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe gjeti se:

Kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Prokurori i Shtetit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se aktvendimet e kundërshtuara me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë janë të pa mbështetura në ligj, nga shkak i gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale, respektivisht dispozitën e nenit 1057 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, e cila dispozitë ligjore, në mënyrë shumë të qartë ka parashikuar se “Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji”, andaj, fakti se në këtë çështje kemi të bëjmë me përmbare të aktgjykimit ASC-09-0084 dhe ASC-090101 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, i cili ka marrë formën e prerë më datë 13.09.2012, pra para datës 19 Dhjetor 2012, nuk i jep asnjë të drejtë përmbaresit privat e as gjykatës që të aplikoj ndonjë interpretim

ligjor tjetër për një çështje të gjykuar. Kjo do të thotë së në kuptim të dispozitës së nenit 1057 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve nuk mund të bëhet asnjë ndërhyrje në dokumentin përmbartimorë, në bazë të së cilit është vendosur për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 19.12. 2012, kur ka hyrë në fuqi ky ligj.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e vet e kishte refuzuar si të pa bazuar kërkesën për eliminimin e parregullsive të pretenduara nga debitori të datës 12.06.2019 dhe kishte refuzuar anulimin e Konkluzionit përmbartimor P.nr.162/2015 për sa i përket aplikimit të kamatës sipas shkallës së ndryshuar me ligjin e ri të marrëdhënieve detyrimore.

Gjykata e Apelit në procedurën e ankimimit, për arsyet e njëjta juridike dhe faktike ka pranuar si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e te autorizuarit të kreditorit duke e aprovuar në tërësi arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shteti, mbështetet në pretendime të natyrës së tillë për të cilat kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kryesisht është e kufizuar, prandaj edhe vlerësohen si pretendime të pathemelta.

Me dispozitën e nenit 247 paragrafi 1, përcaktohet se: “ *Prokurori publik mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë: a) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore; b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale”.*

Pretendimin e Prokurorit të Shtetit, me referencë në dispozitën e cituar nga neni 247 paragrafi 1, të LPK-së, lidhur me shkeljen e pretenduar për shkak të zbatimit të kamatave në shkallë prej 8% pas ditës së hyrjes në fuqi të Ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore u

konsideruan si të pathemelta. Gjykata me të drejtë, vlerësoi se nuk qëndron pretendimi i debitorit lidhur me llogaritjen e kamatës, e në rastin konkret Përmbaruesi Privat Arben Gashi, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me rastin lëshimit të konkluzionit P.nr.163/2015, me të cilin e ka autorizuar ekspertin për llogaritjen e kamatës, dhe atë për periudhën nga data 26.02.2000 deri më datë 31.12.2012 ka llogaritur kamatën në lartësi prej 3.5%, ndërsa nga data 01.01.2013 deri me datë 31.12.2018 ka llogaritur kamatën në lartësi prej 8%, ka vepruar drejtë për shkak se vendimi në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, është marrë më datë 13.09.2012, i cili është vendim i formës së prerë për shkak se vendimi është marrë nga Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ndërkaq Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978 ka qenë në fuqi deri me datë 19.12.2012, ndërsa nga kjo datë në mënyrë të heshtur ky ligj është shfuqizuar nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili është në fuqi nga datë 09.12. 2012 e i cili vazhdon të jetë në fuqi.

Në këtë rast Gjykata Supreme pretendimin e debitorit për shkeljen e referuar e ka vlerësuar në frymën e dispozitës së cituar, por duke marrë në konsideratë specifikat e procedurës përmbarimore, nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit por edhe pretendimet për shkeljet në fazën e zbatimit të përmbarimit. Në këtë kontekst pretendimi i Prokurorit të Shtetit se është zbatuar gabimisht e drejta materiale është i paqëndrueshëm sepse në rastin konkret marrëdhënia detyrimore ka lindur para hyrjes në fuqi të LMD-së por shkalla e kamatës i nënshtrohet nenit 28 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, ku është paraparë se "Në qoftë se kamatëvonesa ka ndryshuar pas nxjerrjes të dokumentit përmbarimor, organi përmbarues sipas detyrës zyrtare do të aplikoj kamatën sipas shkallës së ndryshuar gjatë kohës në pajtim me Ligjin për marrëdhëniet detyrimore" dhe Gjykata Supreme e Kosovës e mbështet arsyetimin e Gjykatës së Apelit e cila vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit, se organi përmbarues e ka ndryshuar aktgjykimin e formës së prerë, por ai e ka ndryshuar vetëm shkallën e lartësisë së kamatëvonesës në pajtim me nenin 28 të LPP-së e lidhur me nenin 382 të LMD-së.

Të drejtën, gjegjësisht detyrimin sipas detyrës zyrtare për ta ndryshuar kamatëvonesën organit përmbarues ia ka dhënë dispozita e nenit 28 të LPP-së që u citua më lartë. Sipas kësaj dispozite dokumenti përmbarimor do të ndryshohet sa i përket çështjes së

kamatëvonesës prej organit përmbarimor. Me dispozitën e nenit 22 të LPP-së është paraparë se dokument përmbarimor është edhe vendimi gjyqësor, e rrjedhimisht sipas nenit 28 të njëjtit ligj ai edhe duhet të ndryshohet sa i përket kamatëvonesës e madje sipas detyrës zyrtare kur ndryshon shkalla e saj në pajtim me nenin 28 të LPP-së.

Për arsyet e sipër theksuara me lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 245 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

CML.nr. 10/2021, më datë 08.02.2022

Kryetari i kolegjit, gjyqtari

Erdogan Haxhibeqiri